



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:098534  
Datë: 08.11.2024  
Numri i dokumentit: 06425803

A.C nr.4232/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Adnan Konushevc, kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hunaida Pasuli , anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve G. K. nga P., V. P. M. nga P., A. Vu. nga P., M. K. A. nga P., të cilin sipas autorizimit i përfaqëson, E. G. avokate nga L., kundër të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës- SHSKUK, Qendra Klinike Universitare e Kosovës- QKUK, me seli në Prishtinë,e përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura Shtetërore, për kompensimin e pagës së 13-të, për vitet 2018, 2019, 2020, dhe 2021 duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.2437/21, të datës 09.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.11.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e G. K. nga P., V. P. M. nga P., A. Vu. nga P., M. K. A. nga P., ndërsa aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2437/21, të datës 09.03.2023, VËRTETOHET.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.2437/21, të datës 09.03.2023, ka vendosur si në vijim: *I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadija e paditësve G. K. nga P., V. P. M. nga P., A. Vu. nga P., M. K. A. nga P., me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës- SHSKUK, Qendra Klinike Universitare e Kosovës- QKUK, që t'ia kompensojë pagën e 13-të, për vitet 2018, 2019, 2020, dhe 2021, t'ia paguaj shumat e mjetëve prej 2,406.00 euro për paditësin G.K. nga P., për paditësen V. P. M. nga P. shumën prej 2,406.00 euro, për paditësin A. V. nga P. shumën prej 1,977.00 euro, për paditësen M. K. A. nga P. shumën prej 2,406.00 euro, e të gjitha t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës”.*

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi ankesën e paditësit si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe të aprovohet kërkesëpadija e paditësit si e bazuar ose aktgjykimin e atakuar ta prish dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur e paditura, me propozim që të refuzohet në tërësi ankesa e palës paditëse, ndërsa aktgjykimin i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e paditësit është e pa themeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 18.05.2021 në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e pagës së 13-të, kundër të paditurës, me detaje të tjera të përshkuara si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitat e nenit 399 par.1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara*

*në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura, andaj gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë dispozite ligjore, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.*

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: në mes palëve nuk ishte kontestuese se paditësi është e punësuar te e paditura, ku për paditësin G. K. (vërtetohet në bazë të kontratës së punës të dt.29.10.2014), si dhe Vërtetimet mbi përvojën e punës të dt.01.09.2022; për paditësin V. P. M. (vërtetohet në bazë të kontratës së punës të dt.05.01.2014) si dhe Vërtetimet mbi përvojën e punës të dt.01.09.2022; për paditësin A. V. (vërtetohet në bazë të kontratës së punës të dt.04.01.2013), si dhe Vërtetimet mbi përvojën e punës të dt.13.09.2022; për paditësin M. K. A. (vërtetohet në bazë të kontratës së punës të dt.04.01.2013) , si dhe Vërtetimet mbi përvojën e punës të dt.01.09.2022.

Në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 11.06.2018, në nenin 17, paragrafi 2 është përcaktuar se “Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”. Kjo dispozite në këtë kontratë është në diskrecion të plotë të punëdhënësit për pagesën e pagës se 13-të, dhe varet ka mundësitë buxhetore të planifikuara. Mbi këtë bazë dhe duke qenë se paditësit nuk kanë prezantuar prova me të cilat vërteton bazueshmërinë e kërkesëpadisë konform nenit 7 lidhur me nenin 319.1 të LPK-së.(*me decidivisht si në arsyetim të këtij aktgjykimi*). Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 399 të LPK-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e shkallës së parë e ka marrë duke u mbështetur në dispozitivin e nenit 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 5 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Me nenin 17 paragraf 2, të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 12.06.2018 përcaktohet se: *“Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit.”*. Andaj, në rastin konkret paditësit me të drejtë i është refuzuar për vitet 2018, 2019, 2020, dhe 2021, t’ia paguaj shumat e mjeteve prej 2,406.00 euro për paditësin G. K. nga P., për paditësen V. P. M. nga P. shumën prej 2,406.00 euro, për paditësin A. V. nga P. shumën prej 1,977.00 euro, për paditësen M. K. A. nga P. shumën prej 2,406.00 euro nga punëdhënësi i fundit, në këtë rast e paditura, pasi që sipas njoftimit të të paditurës me, per vitin 2020 si dhe Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për vitin 2020, të publikuar në Prishtinë, Korrik 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, vërtetohet se e paditura, nuk ka pasur mundësi buxhetore për pagesën e pagës së 13-të. Këtë fakt e mbështet edhe qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar mendimit juridik të saj (*mendimi juridik për zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale lidhur me kërkesat e pagës së 13-të, të punëtorëve të shëndetësisë e dt.09.10.2023, faqja 2, pasuesi i fundit*), ku përcaktohet se: Nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit-pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë.

Prandaj, për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë, për çka edhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:098534  
Datë: 08.11.2024  
Numri i dokumentit: 06425803

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

A.C nr.4232/2023, me datë 06.11.2024

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari  
Adnan Konushevci